

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

IRMA SOKOLI (BILALI)

NAIM FRASHËRI DHE HISTORIOGRAFIA E LETËRSISË SHQIPE

Teza doktrale “**Naim Frashëri dhe historiografia e letërsisë shqipe**” synon të vendosë në qendër të vëmendjes trajtimin e figurës së poetit, kryesisht veprës së tij në optikën studimore të letërsisë shqipe. Termi historiografi letrare në titull dhe në rrjedhën e punimit është përdorur për të përvijuar fushën përkatëse të studimit si dhe një nocion përgjithësues të fenomeneve letrare ku vendin kryesor e zë paradigma e historisë së letërsisë: autori, letërsia, tradita.

Qëllimi i këtij punimi shtrohet në këtë kontekst, ai synon të thellohet në linjat historikisht të përcaktuara ku është trajtuar figura e poetit, kryesisht vepra letrare e tij në rrjedhën e historiografisë letrare shqiptare. Krijimtaria poetike e Naim Frashërit është analizuar dhe interpretuar në dimensionet e ndryshme në studimet për letërsinë shqipe. Si një vepër kulmore e letërsisë shqipe kjo krijimtari ka prapavijën e vet e cila mund të konsiderohet si një traditë më vete me rëndësi esenciale në rindërtimin e vlerave kulturore të kombit. Aty ndërtohet objekti i njohjeve të rëndësishme kritike me anë të instrumenteve teknike të nevojshme si një fenomen i natyrshëm i cili gjen terrenin e vet të përshtatshëm në hapin e kohës. Imazhi konceptual i lexuesit të sotëm si dhe ai i brezave pasardhës mbi Naim Frashërin ashtu si për autorët e tjerë duhet të ndërtohet mbi bazën e studimeve të thella e të vërteta. Kjo detyrë po shtrohet vazhdimisht nga studiuesit, si F. Dado kur shprehet “vlera dhe domethënia historike e autorëve dhe veprave të veçanta gjithnjë do të rivlerësohen”¹ e po ashtu edhe studiuesi Shaban Sinani kur përcakton synimet për shkrimin një historie të re letërsie në një ndër pikat thekson “*Të vlerësohet shkencërisht tradita letrare në Shqipëri, prej fillimeve deri në kohën e sotme, duke iu referuar jo vetëm cilësimit të përgjithshëm të dukurive dhe periudhave letrare, por edhe secilit personalitet më vete dhe veprave të tyre*”². Në këtë këndvështrim ndoshta mund të flasim për një ridimensionim të poetit në kuadrin e pasurimit të traditës letrare shqipe.

Sipas studiuesve me interes është të trajtohet mënyra se si historiografia letrare ka parë Naim Frashërin dhe si ka ndryshuar këndvështrimi në aspektin diakronik. Shaban Sinani shprehet se *Vjershëria e Naimit dhe letrarësia e tij në përgjithësi do të vazhdojnë të pasurohen në të dyja rrugët: përmes zbulimit të herëpashershëm të shkrimeve të tij e për të, si dhe përmes leximeve alternative, që çdo brez do t'i ofrojë vetes*.³

Kemi zgjedhur Naim Frashërin sepse çmohet si një figurë strategjike dhe ecuria e studimit të kësaj figure na ndihmon edhe për të kuptuar mënyrën se si

¹ F. Dado, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë, 2009, f. 309.

² Sh. Sinani, *Historia e letërsisë shqipe: Çështje të hapura*, Naimi, Tiranë, 2015, f. 30.

³ Sh. Sinani, *Naimit*, Shtëpia botuese N. Frashëri, Tiranë, 2000.

është zhvilluar historiografia jonë letrare dhe problematikat që ka pasur në periudha të ndryshme gjatë shekullit XX.

Në interesat tona shtrohen pyetje si: A është hetuar mjaftueshëm dhe a është punuar rigorozisht për një figurë e cila në një kontekst historiko-kulturor vendoset përkrah mitit të heroit kombëtar si poeti kombëtar? A mund të ketë një klasifikim tipologjik në traditën studimore naimiane?

A është analizuar bindshëm dhe mjaftueshëm poeticiteti i vargut të Naimit? Si është parë situata estetike e kësaj vepre? Cilat janë modelet që i afrohen më shumë pikëpamjeve shkencore të studimit letrar në këtë rast dhe ku duhet të referohemi për një paraqitje krahasuese? A mund të arrihet në një gjykim të përgjithshëm, a mund të gjenden kritere universale të vlerësimit?

Pavarësisht punës së vazhdueshme kërkimore, botimeve të shumta e voluminoze mbi figurën emblematike të Naim Frashërit nuk mund të themi që ka një histori të kritikës mbi këtë autor, pavarësisht përpjekjeve sporadike në forma përmbledhjesh të shkrimeve kritike.

Rezultatet e punimit nuk synojnë të jenë thjesht përshkrime të vëzhgimeve, por të përfaqësojnë një zgjidhje të pjesshme të problemit shkencor, lidhja mes autorit, veprës dhe studimit rreth tij në rrjedhën historike. Një operacion kulturor më vete është sintonizimi i fragmenteve të shpëputura në një njësi kontinuitive.

Në një hark kohor mbi një shekullor performanca letrare e këtij autori ka tërhequr një numër të madh studiuesish dhe sfida në këtë rast është e një shkalle vështirësie të konsiderueshme, por gjithashtu e një vlere mbarëkombëtare. Kthesat e skajshme në rrugëtimin e historiografisë letrare shqipe, mungesa e një historie të kritikës si dhe kushtëzimet e ndërlikimet e procesit letrar shqiptar përbëjnë një problem më vete.

Të merresh me interpretimin, siç e pranon edhe Rugova në veprën e tij studimore “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqipe”, *është tejet e vështirë*, ndaj në krye të herës duhet pranuar se ky është një këndvështrim linear i cili synon më së shumti të paraqesë një plan veprues të studimit letrar shqiptar karshi figurës dhe veprës së Naim Frashërit sesa një shqyrtim kritik i asaj që është thënë e shkruar për të.

Kjo trajtesë bazohet mbi një këqyrje të kujdesshme të shtrirë në një kohë reflektimesh dhe konsultimesh përkatëse. Në themel të punës qëndron qëllimi për të vështruar problemet e trajtuara në një dritë të re.

Kërkimi bazohet në një ndërthurje dhe implementim metodash të ndryshme që synojnë të realizojnë qëllimin e studimit. Gjithashtu i parë në lidhje me historiografinë letrare shqipe, punimi shfaq një këndvështrim historiko-kritik të tipit të kërkimit krahasues-shkakësor në lidhje me mendimin kritik shqiptar të shfaqur në kohë.

Në një evidentim të shpejtë, duke pasur parasysh edhe mendimin e studiuesve⁴, duhet theksuar se duket është e vështirë, pothuajse krejtësisht e pamundur që, në rrugën e zhvillimit epistemologjik të mendimit kritik letrar shqiptar të gjesh vepra kritiko- letrare në të cilat prodhimtaria letrare shqipe të jetë trajtuar nga perspektiva e një metode të vetme. Edhe tek një autor i vetëm, në periudha të ndryshme të veprimtarisë së tij kritiko- letrare, hasim një bashkëveprim e bashkekzistencë metodash.

Duke zbritur në hullitë e sistemit të kritikës sonë letrare vërejmë se interpretimet për Naimin në rrjedhë të kohës më së shumti kanë pasur tipare gjeneralizuese, panegjerike, të ndikuara nga ideologjia e duke theksuar kryesisht aspektin patriotik e moralizues. Shpeshherë shkrimet paraqiten me frymë patetike të fokusuara tek numërimi i veprave, rendi bibliografik etj. Përgjatë kësaj rrjedhe zhvillimore mbahen parasysh përpjekjet me vlera shkencore të autorëve të mendimit shqip, duke nisur që prej përmbledhjes me shkrime nga studentët e Vjenës kushtuar 25-vjetorit të vdekjes së poetit, me veprat të tjera të autorëve, grup autorëve e në rang institucional që kulmojnë në vitin 2000 në përkujtimin e 100-vjetorit në përmasa të shumëllojta ku veçojmë veprën “Naimit” me parathënie nga studiuesi Shaban Sinani e cila përmbledh një numër të konsiderueshëm shkrimesh të autorëve të ndryshëm rreth figurës naimiane, për të vijuar deri në ditë e sotme me trajtime të reja. Një kontribut specifik në rikonstruksionin e vlerave sjellin konferencat, simpoziumet, sesionet shkencore të vazhdueshme kushtuar në vite figurës naimiane të cilat pasurojnë stadet e ligjërimit kritik.

Në çështjet e këtij punimi bëjmë përpjekje për të dalluar pikëpamjet, nivelin dhe thellësinë e interpretimeve të vazhdueshme kërkimore.

Me qëllim që opusi kritik mbi Naimin si pjesë e rëndësishme e historiografisë së letërsisë shqipe të ndriçohet sa më shumë, studimit i paraprin një vështrim i përgjithshëm mbi historiografinë si makrostrukturë e shkencës së letërsisë. Në kufijtë e interpretimeve kushtuar Naim Frashërit dhe veprës së tij metakritika paraqitet si një hapësirë brenda së cilës lëvizin modelet e kritikës.

Në këtë kontekst hapat e punës lidhen me refleksionin ndaj leximit të veprës së Naimit nga mendimtarët duke mos lënë mënjane një pjesë të konsiderueshme të studimeve që vijnë në formën e rileximeve të teksteve naimiane. Këndvështrimi i ri kundrejt veprave letrare të Naimit ka sjellë edhe risi në fushën e historiografisë letrare shqipe.

Në studimet mbi Naimin ne jemi përqendruar tek ato historiko-letrare. Një nga synimet është të tregohet dhe të argumentohet se si është hulumtuar mbi figurën e autorit të quajtur poeti kombëtar i shqiptarëve në vëllimet e Historisë së Letërsisë të viteve maket 1955, botimet në tre vëllime të plota të vitit 1959, e më pas ajo e vitit 1983 si dhe asaj të shkruar nga Robert Elsie më 1995. Kemi parë si prurje të rëndësishme bashkëkohore që shtrihen në nivelet fushës së historiografisë

⁴ A. Hoxha, *Racionaliteti dhe objektiviteti si masë e zhvillimit të mendimit kritik letrar shqiptar*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike 32-33, 2002-2003, f. 397-411.

letrare veprat “Sfida teorike e historiografisë shqiptare” me autore Floresha Dado 2009, “Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe”, 2011 me autor Ymer Çiraku deri tek veprat më të fundit si ajo e studiuesit Ali Xhiku “Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe” e botuar më 2014 si dhe “Çështje të hapura nga historia e letërsisë” e studiuesit Shaban Sinani. Gjithashtu në rrezën e këtij vështrimi shtrihet edhe hulumtimi në veprat studimore historiko-letrare të Rexhep Qoses me objekt periodizimin dhe analizën e Historisë së Letërsisë Shqipe. Studimi mbështetet në faktet, vërejtjet, reflektimet e shpalosura në vepra dhe veçanërisht tek hapësirat kushtuar N. Frashërit në këto vepra bazë të historiografisë sonë. Në rrethet studimore pranohet gjerësisht se kahu i studimeve letrare në Shqipëri, kryesisht ka qenë i drejtuar për nga studimet diakronike.

Duke përcaktuar këtë format jemi përballur me një vijueshmëri të përfaqësimit të figurës së poetit nën simbolikën e romantizmit si periudhë letrare. Shpeshherë vetë vepra e Naimit përcakton tiparet e asaj periudhe duke u marrë si model i referencës. Ai duket të sublimojë artin e romantizmit në trashëgiminë letrare të kësaj periudhe në Shqipëri. Pavarësisht polemikave për kohështrirjen, periodizimin, emërtimin e rrymës në lidhje me tiparet e veçoritë e shfaqura, vendi i kreut të epokës për Naimin mbetet i palëvizshëm.

Një objektiv i rëndësishëm i punës përqendrohet në këndvështrimin krahasues të raportit historik mes studimeve të hershme historiko-letrare, vitet '30 të shek. XX, Historive të letërsisë Shqipe, dhe teksteve kritike që shkruhen sot mbi Naim Frashërin për të përcaktuar saktë vendin e tij në historinë e letërsisë shqiptare.

Vepra e këtij poeti përfaqëson pjesën më të avancuar, më të përparuar inteligjencës patriotike demokratike shqiptare në periudhën në të cilën ai shkroi. Këtë fakt e kanë vënë re sigurisht të gjithë biografët, poetët bashkëkohës e pasardhës të autorit, kritikët që e bënë objekt të punës së tyre që në gjallje dhe menjëherë pas vdekjes duke filluar me Mit'hat Frashërin si pinjoll i familjes Frashëri, i cili solli dëshmitë e para në formën e jetëshkrimit për poetin, për të vijuar me Asdrenin që cilësohet edhe si vëzhgues i afërt i poezisë së Naimit dhe vazhdues i traditës poetike të Naimit, dhe mendimtarët si Faik Konica, Krist Maloki, Eqerem Çabej, Musine Kokalari, Nonda Bulka, Namik Resuli e të tjerë emra që gjenden në shtypin e kohës dhe i kushtojnë vëmendje me shkrimet e tyre personalitetit të Naim Frashërit.

Pas vitit '45 vepra naimiane zë vend kryesor dhe analizohet nga teoricienët dhe historianët e letërsisë shqipe. Dhimitër Shuteriqi është ndër të parët që hedh vështrimin drejt Naim Frashërit me studime të hollësishme si në kapitujt e Historisë së Letërsisë Shqipe, në tekstet mësimore dhe në formatin e monografisë. Zija Xholi evidentohet gjithashtu, me punimet e tij mbi Rilindjen dhe poetin në veçanti. Në harkun kohor 45-vjeçar pozicionohen edhe shumë autorë të tjerë si Razi Brahimi, Besa Vila, Kristo Frashëri, Klara Kodra, Ismail Kadare që arrijnë në një numër deri në 150. Ky gërmim thellohet për të arritur në shtresat më të thella të njohjes me monografinë e Rexhep Qoses “Porosia e madhe”, i cili në kuadrin e një studimi integral ka hulumtuar mbi autorin dhe tiparet e veçoritë që e lidhin me periudhat letrare kryesisht Romantizmin. Rexhep Qosja ndër të tjera ka drejtuar

edhe botimin kolanës me veprën e Naimi Frashërit në vitin 1978 në Prishtinë të shoqëruar me parathënie nga vetë studiuesi. Me interes në brendësi të punimit paraqitet edhe hulumtimi në parathëniet e botimeve të veprës së plotë të Naimit.

Një kontribut të rëndësishëm për zbulimin e tipareve të krijimit artistik naimian sjellin studimet e Jorgo Bulos, kryesisht vepra “Tipologji e lirikës së Naim Frashërit” por edhe shqyrtime kritike në shumë vepra të tjera. Analiza dhe interpretime shumëplanëshe me objekt figurën e poetit Naim Frashëri paraqesin Sabri Hamiti, Ibrahim Rugova, Qazim Qazimi, Agim Vinca, Ali Aliu etj. Këtyre kontributeve i shtohen edhe shkrimet e autorëve të huaj si Norbert Jokli, Ania Desnickaja, Robert Elsie etj. Në tërësi shkrimi naimian ka një rëndësi të dorës së parë për gjithë zhvillimin e letërsisë sonë.

Krijimtaria e Naim Frashërit ka qenë pjesë e përhershme e botimeve shkollore. Në kuadrin e didaktikës ky personalitet ka zënë vend në librat teorikë apo antologjitë, tekstet e interpretuara, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, akademik e shkencor duke filluar me tekstet e para që datojnë në vitet '20 të shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme. Këtu përqendrohet një tjetër aspekt i kërkimit tonë. Vëmendjen tonë në këtë çështje të punimit ia kushtojmë zhvillimit të kësaj disipline në arsimin e mesëm në shkollën shqiptare.

Që nga 1925 kur shkruhet i pari tekst shkollor për shkollat e mesme nga Justin Rrota, duke vijuar në vitin 1936 me tekstin e hartuar nga E. Çabej me pjesë të zgjedhura nga literatura letrare për shkollat e mesme, e më pas me vëllimin e Namik Resulit “Shkrimtarë shqiptarë” në dy vëllime i iniciuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare e deri në botimet aktuale shkollore, në tekstet alternative të shtëpive të ndryshme botuese, emri dhe vepra e Naim Frashërit e shoqëruar me analizat përkatëse nuk kanë munguar asnjëherë në kurrikulën lëndore të letërsisë të segmentuara në kohështirjen e kësaj lënde në vitet e shkollës së mesme. Ky korpus i rëndësishëm i edukimit arsimor, pavarësisht përdorimit të njërës apo tjetrit tekst mësimor me një funksionalitet të organizuar, shtron çështje dhe teza të vazhdueshme gjithmonë në drejtim të diskutimeve hapura në rrethet e ndryshme studimore. Qëllimi themelor i lëndës mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë është t'i aftësojë nxënësit për të komunikuar në ligjërimin e folur dhe të shkruar, të përdorin drejt gjuhën standarde shqipe dhe të lexojnë në mënyrë kritike veprat letrare. Autorët e teksteve shkollore i qasen në ide e konceptime interpretive kritike të cilat variojnë sipas periudhave kohore, qëllimeve, rrethanave e situatave.

Mësimdhënia si bazë e formimit të kombit ka shpërfaqur në vite pjesën më të madhe të veprës naimiane, mbi bazën e programeve mësimore të përcaktuara, të shoqëruar nga një analizë e detajuar dhe një aparat pedagogjik në funksion të objektivave mësimore të lëndës së letërsisë. Duke qenë thelbësore për letërsinë shqiptare paraqitja e opusit poetik të Naimit sigurisht zë një vend strategjik në doktrinën e letërsisë. Krijimtaria poetike e Naimit është konceptuar dhe përshkruar në mënyra të ndryshme, ku vihen re edhe modele të ngurta dhe stereotipe të cilat nuk marrin parasysh identitetin e plotë dhe diversitetin e vlerave estetike. Besoj se është vendimtare dhe zgjon interes për zgjidhjet metodologjike, të shqyrtohet rrjedha e analizës shkencore tekstuale ndaj kësaj krijimtarie. Nëpërmjet qasjes nga

pikëpamjet shkencore, interpretimit të saktë dhe shqyrtimit të kujdesshëm e të detajuar, poezia e Naimit do të jetë në gjendje të prodhojë procese të reja transformuese në zhvillimet e disiplinës së letërsisë e në kulturën shqiptare në tërësi.

Materialet shkollore janë një burim i përbashkët dijesh që rrjedh në shkollë dhe që shpërndahet gjithandej duke gjeneruar një bashkëjetesë solide mes të gjithëve ne. Në gjykimin tim si mësimdhënëse në boshtin aksiologjik mbi të cilin shtrihet historia e letërsisë shqipe personaliteti i Naim Frashërit është një gur kilometrik me një rëndësi esenciale. Në një raport përpjestimor të vendit që autorët zënë në historinë e letërsisë shqipe, është evident fakti se N. Frashëri zë një vend parësor në programin e lëndës së letërsisë.

Poezia naimiane është kthyer në një varg kult që na transmeton një mesazh të rëndësishëm tek secili brez në çdo kohë. Vetë poeti është bërë burim frymëzimi për shumë autorë që i drejtohen asaj me vargje e numri i tyre shkon mbi 100 poetë të cilët i kushtojnë vargje figurës simbolike të kombit, Naim Frashërit. Ndër një mori emrash gjejmë vargjet Mihal Grameno, Koto Hoxhi, Filip Shiroka, Çajupi e Asdreni, Bendo Bardhi, Dritëro Agollit, Ismail Kadare, Bilal Xhaferri, Ali Podrimja, por edhe Moikom Zeqo, Klara Kodra, Agim Vinca Sabri Hamiti, Visar Zhiti⁵.

Në mënyrën më të zakonshme vargje e Naimit mësohen në shkollë pasi janë pjesë pothuaj e të gjitha teksteve shkollore që nga abetarja, te leximi letrar e më pas në faqet e librit të letërsisë së gjimnazit (pavarësisht teksteve alternative sipas shtëpive të ndryshme botuese) në gjithë arsimin parauniversitar. Emri dhe vargjet e Naimit përpara se të vinin tek ne kanë kaluar nga dora e prindërve tanë, gjenden në biblioteka pothuaj të çdo shtëpie si vëllim më vete ose brenda teksteve mësimore të koleksionuar ndër vite, duke kontribuar të ndërtojmë njohjen tonë kolektive.

Në të gjithë traditën mësimdhënëse vlerësohet lart figura e Naimit i cilësuar si apostull i idesë nacionale⁶, poeti kombëtar i shqiptarëve, figura qendrore e Rilindjes. Në përfundim të analizës së tij mbi N. Frashërin, Çabej e quan atë patriot pan shqiptar, bir i vonë i romantizmit, të ndikuar nga shkrimtarët frëng. Këtë influencë studiuesi e sheh të përzier me ndikimin e poezisë perse, e cila shfaqet me ngjyra mistike islamike në vargjet e Naimit. Gjithashtu albanologu i njeh Naimit veçorinë e të jetuarit brenda në histori dhe si pasojë trajton lëndën historike në veprat e tija⁷. Gjykimet e mendimtarit E. Çabej kanë qenë një pikë e fortë referimi për studiuesit e mëvonshëm dhe vazhdojnë të zënë vend në analizat filologjike të teksteve shkollore.

Në vështrim diakronik konceptimi i teksteve për lëndën e letërsisë ka ndryshuar i ndikuar nga faktori letrar dhe jashtëletrar. Gjatë dekadave të kaluara është synuar që të emetohet një model i caktuar i njohjes dhe interpretimit të

⁵ M. Gëzhilli, *Naimi 1*, Antologji poetike, Argeta –Lmg, Tiranë, 1996.

⁶ E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Excipere, Çabej, Tiranë, 2009.

⁷ Po aty f. 48.

Naim Frashëri dhe historiografia e letërsisë shqipe

letërsisë. Përgjithësisht është konceptuar historia e letërsisë si një formë mësimi për letërsinë shqipe. Madje dhe vetë tekstet janë titulluar si histori letërsie.⁸ Në kuadër të këtij konceptimi janë trajtuar edhe drejtimet letrare e veprat e shkrimtarëve shqiptarë të lidhura ngushtë me historinë e kombit. Nën orientimin ideologjik për një gjysmë shekulli në librat e historisë dhe të letërsisë, në vitet e pasluftës së II botërore, dënohej dhe demaskohej dukshëm klasa e bejlerëve dhe kulakëve prej nga vinte dhe vetë Naimi megjithëse e gjithë Rilindja është meritë e kësaj klase të cilët e bënë Shqipërinë të pavarur. Vetë studiuesi R. Qosja shprehet për disa probleme në lidhje me aspektin studimor të letërsisë. *Edhe në Historinë e letërsisë shqipe për shkolla të mesme të prof. Dhimitër Shuteriqi janë shprehur qëndrime të njëanshme për shkak të shikimeve ideologjike e politike të lëndës letrare.*⁹

Megjithë përngulitjes në mendjen dhe zemrën e pothuaj çdo shqiptari të vargjeve më të ndjera nga bota poetike e N. Frashërit falë kjo kryesisht përçimit të tyre në orët e mësimi në shkollë, besoj se ka akoma për të shqyrtuar dhe për të nxjerrë në dritë nga vlera e krijimtarisë së këtij autori. Trashëgimia kulturore e një kombi është tregues i rëndësishëm identitetit dhe autenticitetit të tij, ajo i përket memories sonë të përbashkët dhe më shumë se kujtdo i përket së ardhmes e në këtë kontekst brezit të ri i cili rritet dhe edukohet në shkollë. Tradita e studimit të letërsisë lidhet ngushtë me shkollën dhe shoqërinë shqiptare. Kjo çështje e studimit synon të zbulojë prapa fakteve e dukurive konkrete rrjedhën e zhvillimit të ligjërimit kritik kushtuar Naim Frashërit në didaktikën mësimore të lëndës së letërsisë.

Meqenëse tekstet shkollore janë pjesë e historiografisë letrare shqipe, kjo çështje e trajtesës bëhet pjesë e një kërkimi më të gjerë brenda kësaj disipline.

Ne mund të pohojmë që ky studim vendos raporte mes ndërmjet letërsisë kombëtare (figurës së Naimit), traditës së studimit naimian, dhe nivelit të kritikës shqipe. Për këtë tezë është siguruar një bibliografi mjaft e gjerë e cila mundëson hulumtimin në lidhje me objektivat e përcaktuara.

Në tërësinë e vet ky kërkim vlen të pasqyrohet si pjesë e shkrimit kritik për argumentin e zgjedhur për trajtim, për konceptimin dhe shqyrtimin e kujdesshëm në plan krahasues të elementeve kritike me objektiv individualitetin krijues të Naim Frashërit në historiografinë tonë letrare. Ai hap rrugë dhe perspektiva të reja në këtë fushë studimi.

Teksti naimian ka një konotacion të gjerë si një tekst dinamik i aftë për të evidentuar aspektet kritike të traditës së mendimit shqiptar. Sot vijnë artikuj e studime të ndryshme mbi këtë vepër të rëndësishme që ecin në rrugëtime të reja.

⁸ *Historia e letërsisë shqiptare* 1 (për shkollat e mesme), Grup autorësh, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë, 1985.

⁹ R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Ashsh, Tiranë, 2000, f. 33.

BIBLIOGRAFI

- A. Hoxha, *Racionaliteti dhe objektiviteti si masë e zhvillimit të mendimit kritik letrar shqiptar*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike 32-33, 2002-2003.
- E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Excipere, Çabej, Tiranë, 2009.
- F. Dado, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë, 2009.
- Historia e letërsisë shqiptare 1* (për shkollat e mesme), Grup autorësh, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë, 1985.
- M. Gëzhilli, *Naimi 1, Antologji poetike*, Argeta -Lmg, Tiranë, 1996.
- R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Ashsh, Tiranë, 2000.
- Sh. Sinani, *Historia e letërsisë shqipe: Çështje të hapura*, Naimi, Tiranë, 2015.
- Sh. Sinani, *Naimit*, Shtëpia botuese N. Frashëri, Tiranë, 2000.